

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 23.06.2024

Problemi 1

Pasqyra e pozicionit financiar të Petriti SH.P.K në datat 31 dhjetor 2022 dhe 2023 janë si vijon:

PASURITE	`000 EUR 2023	`000 EUR 2022
Pasuritë jo qarkulluese		
Investimet afatgjata	4,600	0
Toka me kosto	130,000	110,000
Pajisjet dhe makineritë me kosto	151,000	120,000
Mobiljet me kosto	29,000	24,000
<i>Zhvlerësimi i akumuluar:</i>		
Pajisjet dhe makineritë	-54,000	-45,000
Mobiljet	-15,000	-13,000
Total Pasuritë jo qarkulluese	245,600	196,000
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	51,000	37,000
Llogaritë e arkëtueshme	44,000	42,800
paraja e gatshme	11,400	200
Total Pasuritë qarkulluese	106,400	80,000
TOTAL PASURITE	352,000	276,000
EKUITETI		
Kapitali aksionar	150,000	100,000
Premia në aksione	35,000	15,000
Fitimet e mbajtura	41,000	14,000
TOTAL EKUITETI	226,000	129,000
DETYRIMET		
Detyrimet afatgjata		
Kredia afatgjatë	30,000	70,000
Detyrimet afatshkurta		
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	48,000	34,000
Dividenda e pagueshme	15,000	7,500
Mbitërheqja bankare	0	14,000
Tatimi i pagueshëm	33,000	21,500
Total detyrimet afatshkurta	96,000	77,000
TOTAL DETYRIMET	126,000	147,000
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET	352,000	276,000

Shënime relevante:

- 1) Nuk ka patur shitje të tokës gjatë vitit.
- 2) Një makineri e cila kishte kosto 8,000,000 eur dhe zhvlerësim të akumuluar prej 6,000,000 eur, ishte shitur për 3,000,000 eur.

Mobiljet me kosto prej 5,000,000 eur dhe zhvlerësim të akumuluar prej 2,000,000 eur, ishin shitur për 1,000,000 eur.
- 3) Në pasqyrën e të ardhurave, shpenzimet e tatimit ishin 22,000,000eur. Fitimi neto duhet të gjindet.
- 4) Dividenta e deklaruar gjatë vitit 2023 ishte 15,000 eur, mirëpo pagesa në para e dividendës gjatë vitit 2023 është bërë vetëm për dividendën e deklaruar në 2022, në shumë prej 7,500 eur.
- 5) Interesi i arkëtuar gjatë vitit dhe të hyrat nga interesi ishin 450,000eur. Shpenzimet e interesit në P/A ishin 6,400,000eur. interesi i pagueshëm ishte përfshirë tek të pagueshmet tjera dhe ishte 440,000 eur më 31 dhjetor 2022 dhe Zero më 31 dhjetor 2023.

Kërkohet:

Përgatitni Pasqyrën e Rrjedhave të Arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 sipas SNK 7 me metodën indirekte. **Total 20 pikë**

Zgjidhja e problemit 1

		2023
	Llogaritjet	EUR`000
AKTIVITETET OPERATIVE		
Fitimi neto	LL/1	42,000
shpenzimet e tatimit		22,000
shpenzimet e interesit		6,400
Të hyrat nga interesi		-450
Fitimi operativ		69,950
Korrigjuar për:		
Shpenzimet e zhvlerësimit	LL/2	19,000
Humbja kapitale		2,000
Fitimi kapital		-1,000
(Rritja) në stoqe		-14,000
(Rritja) në të arkëtueshmet		-1,200
Rritja në LL/P	LL/3	14,440
<i>Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet</i>		89,190
<i>Interesi i paguar</i>	LL/4	(6,840)
<i>Interesi i arkëtuar</i>		450
Tatimi i paguar	LL/5	(10,500)
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga Aktivitetet operative		72,300
AKTIVITETET INVESTUESE		
Hyrjet e parasë		
Nga shitja e makinerive		3,000
Nga shitja e mobiljeve		1,000
Daljet e parasë		
Per blerjen e tokes		(20,000)
Per blerjen e investimeve afatgjata		(4,600)
Per blerjen e pajisjeve dhe makinerive	LL/6	(39,000)
Per blerjen e mobiljeve	LL/6	(10,000)
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga Aktivitetet investuese		(69,600)
AKTIVITETET FINANCUESE		
Hyrjet e parasë		
Nga shitja e aksioneve		70,000
Daljet e parasë		
Pagesat e dividenteve		(7,500)
Pagesa e kredisë		(40,000)
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga Aktivitetet financuese		22,500

RRJEDHA NETO E PARASE GJATE VITIT	25,200		
Para e gatshme dhe ekuivalentët në fund të vitit	11,400		
Para e gatshme dhe ekuivalentët në fillim të vitit	-13,800	200	-14,000

LL/1

Fitim i mbajtur saldo ne fillim	14,000
Fitimi neto (shifer balancuese)	42,000
Dividenta e deklaruar	-15,000
Fitim i mbajtur saldo ne fund	41,000

LL/2

Zhvleresimi i akumuluar(Pajisjet dhe makinerite)

	S`	
	45,000	
shitja 6,000	15,000	shpenzimet e zhvleresimit
	S``	
	54,000	

Zhvleresimi i akumuluar
(Mobiljet)

	S`	
	13,000	
shitja 2,000	4,000	shpenzimet e zhvleresimit
	S``	
	15,000	

LL/3

	2023	2022
	`000	`000
LL. e pagueshmet tregtare	48,000	33,560
Interesi i pagueshem	0	440
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe te tjera	48,000	34,000

LL/4

Interesi i pagueshem

	S` 440	
6,840	6,400	shpenzimet e interesit
interesi i paguar		
	S`` 0	

LL/5

Tatimi i pagueshem

	S`	
10,500	21,500	
Tatimi i paguar	22,000	shpenzimet e tatimit
	S``	
	33,000	

LL/6

Pajisjet dhe makinerite me kosto

S` 120,000	8,000	shitja
39,000		
Blerja-shifer balancuese		
S``151,000		

Mobiljet me kosto

S` 24,000	5,000	shitja
10,000		
Blerja-shifer balancuese		
S``29,000		

Problemi 2

Llogaria Kontrolluese e të Arkëtueshmeve e Mana më 31 dhjetor 2023 kishte një saldo prej €105,250; përderisa Llogaria Kontrolluese e të Pagueshmeve kishte një saldo prej €87,180. Asnjëra nga këto saldo nuk ishin në përputhje me listën e saldove individuale.

Gjatë investigimit të diferencës, janë zbuluar çështjet e mëposhtme:

- a) Libri i shitjeve ditore ishte nënvlerësuar prej €1,400.
- b) Bilanci prej €2,500, borxh i arkëtueshëm nga Suzana ishte lënë jashtë nga lista e saldove individuale.
- c) Borxhi i keq prej €2,100 ishte shlyer nga Libri analitik i të arkëtueshmeve por asnjë regjistrim nuk ishte bërë në Llogarinë Kontrolluese.
- d) Një blerje e mallrave nga Genti prej €5,500 ishte regjistruar në anën e gabuar të librit analitik të tij.
- e) Mallrat me vlerë prej €3,300 të cilat i janë kthyer furnitorit nuk janë regjistruar fare në libra.
- f) Një faturë prej €660 është regjistruar në Librin Ditor të Shitjeve si €606.
- g) Kishte rëndë dakord me Durimin për të vendosur saldon në konton e tij në librin analitik të të pagueshmeve prej €2,750 kundër llogarisë së tij (kundër regjistrimet) në librin analitik të të arkëtueshmeve. Sidoqoftë, kjo ishte regjistruar vetëm në librin analitik (lista individuale) të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve.
- h) Gjatë dhjetorit të vitit 2023, kthimet nga shitjet prej €1,800 ishin regjistruar në Llogarinë Kontrolluese si €800.
- i) Libri i blerjeve ditore ishte mbivlerësuar prej €750.
- j) Një arkëtim prej €780 nga klienti Mari shpk ishte regjistruar gabimisht në anën kreditore të llogarisë së Meri shpk në librin analitik të të pagueshmeve. Gabimi është bërë vetëm tek listat individuale.
- k) Saldo prej €1,300 ishte lënë jashtë nga lista e saldove të llogarive të pagueshme.

KËRKOHET:

- a) Përgatitni një llogaritje të saldove të sakta që duhet të regjistrohen në Llogaritë Kontrolluese të të Arkëtueshmeve dhe të Pagueshmeve. **(10 Pikë)**
- b) Gjeni saldot e pakorrigjuara të listës individuale të furnitorëve dhe klientëve **(5 Pikë)**
- c) Përgatitni një deklaratë të harmonizimit të saldove origjinale, të nxjerra nga libri, me saldot e korrigjuara për çdo libër (Librat analitik). **(5 Pikë)**

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 2

a)

Llogaria Kontrolluese e të Arkëtueshmeve

Data	Përshkrimi	Vlera (€)	Data	Përshkrimi	Vlera (€)
Dhj.			Dhj.		
31	Saldo	105,250	31	Borxhi i keq	2,100
31	Libri i shitjeve ditore	1,400	31	Kundër regjistrimi	2,750
31	Gabimi në L.Sh.D. (660-606)	54	31	Kthimet (1,800-800)	1,000
31	Saldo në fund	<u>106,704</u>			<u>100,854</u>
					<u>106,704</u>

Llogaria Kontrolluese e të Pagueshmeve

Data	Përshkrimi	Vlera (€)	Data	Përshkrimi	Vlera (€)
Dhj			Dhj		
31	Kthimet	3,300	31	Saldo	87,180
31	Kundër regjistrimi	2,750			
	Libri i blerjeve ditore	750			
31	Saldo në fund	<u>80,380</u>			
		<u>87,180</u>			<u>87,180</u>

b)

Lista e saldove të Llogarive të Arkëtueshme

	€
Saldo origjinale (Shifër balancuese)	99,080
Saldo e lënë jashtë e Suzana shpk	2,500
Gabimi i Librit të Shitjeve Ditore (660-606)	54
Mari shpk	<u>(780)</u>
Saldo e korrigjuar në fund e LI K A	100,854

Lista e saldove të Llogarive të Pagueshme

	€
Saldo origjinale (Shifër balancuese)	72,160
Genti shpk (5,500 x 2)	11,000
Kthimet	(3,300)
Meri shpk	(780)
Saldo e lënë jashtë	<u>1,300</u>
Saldo e korrigjuar në fund e LI K P	80,380

Problemi 3

Bilanci vërtetues i kompanisë Tana SH.P.K për vitin që përfundon më 30 qershor 2023, është dhënë si në vijim:

	Debi (eur)	Kredi (eur)
Të hyrat nga shitja		526,000
Blerjet	342,000	
Stoqet më 1 korrik 2022	37,500	
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	37,510	
Shpenzimet administrative	36,130	
Lejimet për borxhet e dyshimta		125
Interesi i paguar	625	
Pasuritë jo qarkulluese me kosto:		
Ndërtesat	300,000	
Automjetet	70,000	
Pajisjet e zyrës	25,000	
Zhvlerësimi i akumuluar:		
Ndërtesat		12,000
Automjetet		12,500
Pajisjet e zyrës		1,500
Llogaritë e arkëtueshme	5,020	
Llogaritë e pagueshme		6,270
Paraja e gatshme	27,200	
140,000 aksione të zakonshme nga 1 eur		140,000
5% Obligacionet		25,000
Rezerva e përgjithshme		25,000
Fitimet e mbajtura		140,990
Dividenda e paguar	8,400	
TOTAL	889,385	889,385

Informata shitesë

- i. Stoqet më 30 qershor 2023 janë 29,400 eur.
- ii. Zhvlerësimi ngarkohet kështu:
 1. Ndërtesat 4% metoda drejtvizore
 2. Automjetet 25% metoda drejtvizore
 3. Pajisjet e zyrës 10% metoda e saldove zbritëse
- iii. Lejimet e përgjithshme janë 5%.
- iv. Duhet të shlyhet borxhi i keq prej 200 eur.
- v. Drejtorët kanë vendosur të transferojnë 25,000 eur nga fitimi i mbajtur tek rezervat e përgjithshme.
- vi. Drejtorët kanë propozuar dividend përfundimtare prej 0.07 eur për aksion, ende nuk është deklaruar.
- vii. Obligacionet janë lëshuar në 2019.

Kërkohet

Në përputhje me SNK 1:

(a) Përgatitni Pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse deri më 30 qershor 2023

10 pikë

(b) Përgatitni Pasqyrën e pozicionit financiar më 30 qershor 2023

10 pikë

Total 20 pikë

Zgjidhja e problemit 3

Tana SH.P.K	
Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 30 qershor 2023	
	Eur
Të hyrat nga shitja	526,000
KMSH -LL/1	<u>(350,100)</u>
Fitimi bruto	175,900
Shpenzimet administrative	(36,130)
Shpenzimet e shitjes	(37,510)
Shpenzimet e zhvlerësimit-LL/2	
Shpenzimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta LL/3	(316)
Fitimi operativ	70,094
Shpenzimet e interesit-LL/4	<u>(1,250)</u>
Fitimi neto	<u>68,844</u>

Tana SH.P.K	
Pasqyra e pozicionit financiar më 30 qershor 2023	
	Eur
PASURITE	
Pasuritë jo qarkulluese	
Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet-LL/5	337,150
Pasuritë qarkulluese	
Stoqet	29,400
Llogaritë e arkëtueshme neto 5020 - 200 - 241	4,579
Paraja e gatshme	27,200
TOTAL PASURITE	<u>398,329</u>
Ekuiteti dhe detyrimet	
Ekuiteti	
Kapitali aksionar	140,000
Rezerva e përgjithshme	50,000
Fitimet e mbajtura -LL/6	176,434
TOTAL EKUITETI	<u>366,434</u>
Detyrimet afatgjata	
5% Obligacionet	25,000
Detyrimet afatshkurta	
Llogaria e pagueshme	6,270
Interesi i pagueshëm 1250-625	625
<u>Total detyrimet</u>	<u>31,895</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	<u>398,329</u>

LLOGARITJET

LL/1

Stoqet në fillim	37,500
Blerjet	342,000
Stoqet në fund	-29,400
KMSH	350,100

LL/2

Zhvlerësimi-Ndërtesa

Kosto	300,000
Përqindja	4%

Shpenzimi **12,000**

Zhvlerësimi-Automjetet

Kosto	70,000
Përqindja	25%

Shpenzimi **17,500**

Zhvlerësimi-Pajisjet e zyrës

Kosto	25,000
Zhvlerësimi i akumuluar	-1,500
VNL	23,500
Përqindja	10%

Shpenzimi **2,350**

Total shpenzimet e zhvlerësimit **31,850**

LL/3

Lejimet në fund	5%
LL/A minus Borxhi i keq	4820
Lejimet në fund	241
Lejimet në Fillim	125
Shpenzimet e borxheve të dyshimta	116
Total shpenzimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta	316

LL/4

Obligacionet	25,000
Përqindja	5%
Shpenzimet e interesit	1250

LL/5

Pasuritë jo qarkulluese			
	Kosto	Zhvlerësimi i akumuluar	VNL
	eur	eur	eur
Ndërtesat	300,000	24,000	276,000
Automjetet	70,000	30,000	40,000
Pajisjet e zyrës	25,000	3,850	21,150
	<u>395,000</u>	<u>57,850</u>	<u>337,150</u>

LL/6

Fitimet e mbajtura S`	140,990
Fitimi neto	68,844
Transferi te rezerva	(25,000)
<u>Dividenta</u>	<u>(8,400)</u>
Fitimet e mbajtura S``	176,434

Problemi 4

Njëra ndër detyrat e zakonshme mujore të Arbenit është përgatitja e harmonizimit (rekonsilimit)bankar. Me 30 Qershor Libri i Arkës paraqiste një gjendje në mbitërheqje prej 2,500 €, përderisa ekstrakti i bankës paraqiste një mbitërheqje në vlerë prej 350€.

Arbeni kontrolloi Librin e Arkës dhe Ekstraktin e bankës dhe ka gjetur diferencat e mëposhtme :

- (a) Kompania ka pranuar një çek në vlerë prej 4,000€ dhe e ka regjistruar në Librin e Arkës. Këto ceqe nuk janë transferuar ende në llogarinë bankare.
- (b) Arbeni ka paguar me ceqe në vlerë prej 5,000€, por ende nuk janë paraqitur në ekstrakt.
- (c) Shpenzimet bankare prej 350 € të cilat janë paraqitur në ekstrakt ende nuk ishin regjistruar në Librin e Arkës.
- (d) Çeku në vlerë prej 500 € i pranuar gjatë muajit nga “Drita shpk”, ishte regjistruar dhe ishte dorëzuar në bankë. Fatkeqësisht ky çek ishte kthyer si i papagueshëm më 30 Qershor që edhe shihej në Ekstrakt .Asnjë regjistrim nuk ishte bërë në Librin e arkës për cekun e kthyer.
- (e) Dividenda e pranuar nga investimet në vlerë 2,000€ është pranuar drejtpërdrejt në llogarine e bankës dhe figuronte në Ekstrakt. Asnjë regjistrim nuk është bërë në Librin e Arkës.

Kërkesa:

- 1.Regjistrimi korigjimet në Librin e Arkës. (10 pikë)**
- 2. Përgatiteni harmonizimin bankar për muajin Qershor. (10 pikë)**

(Totali 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

Libri i arkës		
dividenda 2000	Saldo në fillim	2500
	Shpenzimet bankare	350
	Çeqet e kthyera	500
		<hr/>
	Saldo në fund	1350

Ekstrakti i bankës

	Saldo e pakorrigjuar	(350)
Plus		
	Ceqet e paarketuara	4000
Minus		
	Ceqet e papaguara	(5000)
		<hr/>
	Saldo e korrigjuar	<u>(1350)</u>

Problemi 5

Pasqyrat e pozitës financiare të secilës kompani më 31 dhjetor 2023 janë paraqitur në vijim:

	<i>Pentagoni</i>		<i>Mireli</i>	
	€	€	€	€
<i>Pasuritë</i>				
Pasuritë jo-qarkulluese				
Pasuritë e trupëzuara	60,000			20,000
investimet në Mireli sipas kostos	<u>66,000</u>			
		126,000		
Pasuritë qarkulluese				
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	30,000		25,000	
Stoqet	<u>10,000</u>		<u>5,000</u>	
		<u>40,000</u>		<u>30,000</u>
<i>Totali i pasurisë</i>		<u><u>166,000</u></u>		<u><u>50,000</u></u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>				
Ekuiteti				
Aksione të zakonshme nga €1 secila	90,000		20,000	
Fitimet e mbajtura	<u>55,000</u>		<u>22,000</u>	
		145,000		42,000
Detyrimet afatshkurta				
Llogaritë e pagueshme tregtare		<u>21,000</u>		<u>8,000</u>
<i>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</i>		<u><u>166,000</u></u>		<u><u>50,000</u></u>

Pentagoni shpk ka blerë 75% të aksioneve të Mireli shpk më 1 Janar 2023 kur fitimet e mbajtura të Mireli shpk ishin €13,000. Vlera e drejtë e iJK-së në datën e blerjes ishte €11,000. Përgjatë vitit deri më 31 dhjetor 2023, Mireli shpk i shiti mallra Pentagonit për €30,000 me një marzhë mbi kosto prej 25%. 50% e këtyre mallrave ishin akoma të pa shitura nga Pentagoni në fund të vitit. Në të njëjtën datë, Pentagoni i kishte borxh Mirelit €2,000 për mallrat e blera dhe ky borxh është i përfshirë në llogaritë e pagueshme tregtare të Pentagoni dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare të Mirelit.

Kërkohe:

Përgatitni pasqyrën e pozitës financiare të konsoliduar për Pentagoni shpk. [Totali: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 5

Pentagoni shpk

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE E KONSOLIDUAR MË 31 DHJETOR 2023

	€	€
<i>Pasuritë</i>		
Pasuritë jo-qarkulluese		
Pasuritë e trupëzuara (60,000 + 20,000)		80,000
Zëri i mirë (L11)		44,000
Pasuritë qarkulluese		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare (30,000 + 25,000 - 2,000)	53,000	
Stoqet (10,000 + 5,000 - 3,000 (L12))	<u>12,000</u>	
		<u>65,000</u>
<i>Totali i pasurisë</i>		<u><u>189,000</u></u>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
Ekuiteti që i takon mbajtësve të kompanisë mëmë		
Aksione të zakonshme nga €1 secila	90,000	
Fitimet e mbajtura (L13)	<u>59,500</u>	
		149,500
IJK (L14)		<u>12,500</u>
		162,000
Detyrimet afatshkurta (21,000 + 8,000 - 2,000)		<u>27,000</u>
<i>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</i>		<u><u>189,000</u></u>
<i>Llogaritjet</i>		
1 Zëri i mirë	€	€
Vlera e drejtë e konsideratës së transferuar		66,000
Plus vlera e drejtë e iJK-së në blerje		11,000
Minus vlera e drejtë në blerje e pasurive të identifikueshme të blera dhe detyrimeve të pranuar:		
Kapitali aksionar	20,000	
Fitimet e mbajtura	13,000	
		33,000
Zëri i mirë		44,000

2	<i>Provizioni për fitimin e porealizuar</i>		€
	Çmimi i shitjes	125%	30,000
	Çmimi i kostos	100%	(24,000)
	Fitimi bruto	25%	<u>6,000</u>
	Fitimi i porealizuar (6,000 × 50%)		3,000
	Fitimi i porealizuar që i takon grupit (3,000 × 75%)		2,250
	Fitimi i porealizuar që i takon iJK-së (3,000 × 25%)		750
3	<i>Fitimet e mbajtura</i>	<i>Pentagoni</i>	<i>Mireli</i>
		€	€
	Sipas pyetjes	55,000	22,000
	Korrigjimet (fitimi i porealizuar që i takon grupit)	(2,250)	-
	Fitimet e mbajtura para blerjes		(13,000)
			<u>9,000</u>
	Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes:		
	Mireli (75% × 9,000)	<u>6,750</u>	
	Fitimet e mbajtura të grupit	<u>59,500</u>	
4	<i>IJK në datën e raportimit</i>		€
	Vlera e drejtë e iJK-së në blerje		11,000
	Plus pjesa iJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes (25% × 9,000)		2,250
	Minus fitimi i porealizuar që i takon iJK-së (L12)		<u>(750)</u>
	IJK në datën e raportimit		<u>12,500</u>